REGALIS PLUS

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS07

"Lexo fletëudhëzuesin përpara përdorimit"

REGALIS PLUS është regullator i rritjes së bimëve, i cili ka gjetur përdorim të gjerë në mollë dhe dardhë. Pengon 3 ß-hydroxylation të GA_{20} deri tek GA_1 në biosintezën e giberelinës. Duke pakësur nivelin e giberelinës, vepron në rritjen e vonuar të bimëve. Regullator i zhvillimit vegjetativ tek pemët frutore farore (mollë dhe dardhë) si dhe i rritjes tek të lashtat. Tek faroret mund të ndikojë në: një raport optimal mes zhvillimit vegjetativ dhe frutifikimit; lidhje të kënaqëshme të frutave; kurrorë të pemës më kompakte dhe me shpërndarje uniforme të frutave; për rrjedhojë, shërbime më të thjeshta si krasitjet verore dhe dimërore, vjelja, etj. Gjithashtu përmireson cilësinë e frutave. Tek pemët frutore farore vepron dhe si baktericid, pasi kontrollon dhe zjarrin bakterial (*E. amylovora*).

Permbajtja: *Prohexadione Calcium 100 gr/kg.*

Formulimi: *Granula te dispergueshme ne uje (WG)*

Masat parambrojtëse:

Deklaratat e rrezikut

H317: Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës.

EUH401:Te evitohen rreziqet e shendetit të njeriut dhe ambjentit, në përpuethshmëri me instruksionet për përdorim.

Deklarata parandaluese (Parandalimi)

P101: Në rast helmimi tregojeni mjekut etiketën e produktit.

P102: Mbajeni në vende të sigurta, larg fëmijëve.

P103: Lexoni etiketën para përdorimit.

P261: Shmangni thithjen e pluhurit / tymit / gazeve / mjegullës / avujve / solucionit gjatë frymëmarrjes.

P272: Veshjet e kontaminuara të punës nuk duhet të lejohen jashtë vendit të punës.

P280: Vishni doreza mbrojtëse/ veshje mbrojtëse/ pajisje mbrojtëse për fytyrën/ pajisje mbrojtëse për sytë.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun

Deklarata parandaluese (Reagimi)

P302 + P352: NË RAST KONTAKTI NË LËKURË : Lajeni me ujë të bollshëm.

P333+P313: Në rast irritimi ose skuqje të lëkurës: Merrni këshilla / kujdes mjekësor

P362+P364: Hiqni veshjet e ndotura dhe lani veshjet e ndotura para ripërdorimit..

Deklarata parandaluese (Shkatërrimi)

P501: Shkatërroni ose largoni përmbajtjen /ambalazhin në përputhje me rregullat në fuqi.

Perdorimi:

- *Dardhë*, me dozën në vartësi të zhvillimit (fuqisë) të pemëve, e shprehur në kg preparat/ha: 0.75-1.5, për pemët me fuqi të ulët; 1.5-2.25, me fuqi të mesme; 2.25-3, të fuqishme; 3-3.75, shumë të fuqishme.

- *Mollë*, me 0.75-1, për pemët me fuqi të ulët; 1-1.5, me fuqi të mesme; 1.5-2, të fuqishme; 2-2.5, shumë të fuqishme. Trajtimet kryhen në disa duar: gjysma e dozës në fazën e përfundimit të lulëzimit, trajtimi tjetër pas 3-4 javësh. Perdoret 100-200 lit solucion/ha.

- *Të lashta, bimë zbukuruese, tapete me bar*, etj., me 100 gr/100 lit uje, duke perdore 200-500 lit solucion/ha.

Verejtje per perdorimin:

Preparati tretet ne fillim ne gjysmen e dozes se solucionit spekates dhe, duke e perzier, shtohet pjesa tjeter e ujit. Solucioni sperkates te shperndahet uniformisht ne bime. Të mos trajtohet në periudhën kur kryhet diferencimi i sythëve të vitit pasardhës. Në kryerjen e trajtimit të meren në konsideratë, krahas fuqisë së zhvillimit, edhe

kultivari, nën shartesa, mosha, gjendja shëndetësore dhe niveli i lulëzimit dhe lidhjes së frutave, etj. Nuk perzihet me produktet alkaline dhe me dodinen. Ne rast perzierje me produkte te tjera, duhet te hidhet i fundit.

Fitotoksiciteti:
Nuk eshte fitotoksik nese perdoret sipas etiketes. Në varietetet e dardhës Konferenca dhe Doyenne Comice mund ndikojë në krijimin e luleve.

Ndikimi ne ekosistem:
Jo helmues për gjitarët. Mesatarisht helmues për zogjtë. Pak helmues për bletët. Pak helmues për peshqit dhe për jovertebrorët ujorë. Mos ndotni siperfaqet ujore dhe rruget e ujit me produktin, tretesiren sperkatese ose me ambalazhin bosh.

Karenca:
55 ditë.

Magazinimi:
Ruhet ne vende te thata, ne mungese te rrezeve te drites dhe ne temperature 5-35^0 C.

Nr dhe data e regjistrimit: Nr 641 ; date 23.06.2016 .
Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 100, 250, 500 gr; 1 kg.
Data e prodhimit: ...Printuar nga makineria në ambalazh .....;
Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet.
Numri i partise se mallit (serise): Printuar nga makineria në ambalazh ..... ;
Tipi i amballazhit baze: Material i papershkueshem nga lageshtia.
Emri dhe adresa e Aplikantit: BASF Agricultural Solutions Deutschland GmbH. **Adresa**: Speyerer Straße 2, 67117 Limburgerhof, Gjermani.
Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: BASF Agricultural Solutions Deutschland GmbH. **Adresa**: Speyerer Straße 2, 67117 Limburgerhof, Gjermani.
Distributori për Shqipërinë: AgroHelp-SA. sh.p.k, adresa: AutostradaTiranë-Durrës km 22 Xhafzotaj.